
RELACION TEKNIK

**Mbi objektin: "SISTEMIMI I RRUGEVE TE BRENDESHME TE FSHATRAVE
FUSHE VERRI, VERGO DHE PALAVLI " Bashkia Delvine.**

Projekti përfshin:

1. Sistemimi I rruges per ne qender te fshatit Fushe Verri
2. Sistemimi I rruges se vorezave publike te fshatit Vergo.
3. Sistemimi I rruges se vorezave publike dhe rruges ne qender te fshatit Palavli.

Amortizimi dhe gjendja e keqe e rrugeve te fshatrave **Fushe Verri, Vergo dhe Palavli** ka krijuar kushte të vështira kalimi për mjetet dhe këmbesorët prandaj është parë e domosdoshme rikonstruksioni i këtyre rrugeve te cilet do të kene impakt në:

- Kushtet e jetesës së banoreve të fshatit
- Rivitalizimin e zonës përreth
- Zhvillimin ekonomik të kësaj zone

A. Sistemimi i rruges per ne qender te fshatit Fushe Verri

Rruga ka gjtessi $L=220\text{ml}+20\text{ml}$ tek qendra (rethi prej betoni). $B=4.0\text{ml}$

Sistemim i rruges per ne qender te fshatit te Fushe Verri, të Bashkisë Delvinë ka për qëllim të lehtësoj lëvizjen e banorëve dhe mjeteve të tyre.

Tabani i sheshit mbi të cilin do të shtrohet kërkohet të jetë i qëndrueshem (pa cedime të teperta dhe pa zhvendosje) ndaj veprimit të ngarkesave të mjeteve lëvizese dhe i durueshem ndaj veprimit të agjentëve atmosferikë .

Rruga ka gjtessi $L= 220\text{ml} +20\text{ml}$ rrethi dhe gjeresi $B= 4.0 \text{ ml}$

Për realizimin e projektit fillimisht do të kryhen punime rafshim, skarifikim, nivelim me thellesi 10cm, pastaj një nën shtresë zhavori 10 cm te cilat do te ngjeshen me makineri dhe më vonë te shtrohet zgara e celikut Ø4mm, me permasa te kuadrateve 15x15 cm dhe beton M-200 me trashësi 12

Betoni dote jete I markes M-200 dhe do te kryhet ngjeshja me vibrator siperfaqesor.

Ne te dy anet e rruges prej betoni do te shtrojme me zhavor ne forme bankine me gjeresi 2x50 cm. Pusetat ekzistuese te rjetit te ujit te pijshem te te kene nje mbingritje qe te vine rrafsh me betonin. Ne qender tek shkolla eshte menduar te behet nje rreth betoni si rreth rrotullimi.

Shtresat e rruges jane sipas asaj te caktuara ne preventivin e objektit

Pas betonimit te rrugeve do te kihet parasysh trajtimi I shtreses se betonit me uje 2-3 here ne dite kur betonimi do te kryhet ne **temperaturave te larta mbi 37 e 40 grade**. Sikurse te kihet parasysh qe per 15dite mbas betonimit nuk dote kalojne makina te rrenda,sepse mud te demtoje shtrësen e betonit.

B, Sistemimi I rruges se vorezave publike te fshatit Vergo

Sistemimi i rruges nga vorezat publike e deri ne hyrje te fshatit Vrgo, ka për qëllim të lehtësoj lëvizjen e banorëve qe do te levizin ne kete segment rruge..

Tabani i rruges mbi të cilin do të shtrohet kërkohet të jetë i qëndrueshem (pa cedime të teperta dhe pa zhvendosje) ndaj veprimit të ngarkesave të mjeteve lëvizese dhe i durueshem ndaj veprimit të agjentëve atmosferikë .

Rruga ka nje gjatesi L = 540ml Me gjeresi B=3.0ml.

- Germim kanali anesor dheu me makineri me gjatesi 540ml.

Për realizimin e projektit fillimisht do të kryhen punime rafshim, skarifikim, nivelim me thellesi 10cm, pastaj një nën shtresë zhavori ose gurra kave të coptuar 10 cm te cilat do te ngjeshen me makineri dhe më vonë te shtrohet zgara e celikut Ø4mm, me permasa te kuadrateve 15x15 cm dhe beton M-200 me trashësi 12 cm.

Betoni dote jete I markes M-200 dhe do te kryhet ngjeshja me vibrator siperfaqesor.

Pas betonimit te sheshit do te kihet parasysh trajtimi I shtreses se betonit me uje 2-3 here ne dite kjo sipas temperaturave te larta mbi 37 e 40 grade. Sikurse te kihet parasysh qe per 15dite mbas betonimit nuk dote kalojne makina te rrenda,sepse mud te demtoje shtrësen e betonit

C.Sistemimi I rruges se vorezave publike dhe rruges ne qender te fshatit Palavi.

Gjatesia e rruges se vorezave publike nga rruga kryesore eshte L= 90m dhe gjeresia b=3.0m. Pjesa tjeter e rruges do te realizohet ne qender te fshatit Palavli ne drejtim te lagjes me gatesi L= 60m dhe gjeresi b= 3.0m.

Për realizimin e kesaj rruge fillimisht do të kryhen punime rafshim, skarifikim, nivelim me thellesi 10cm, pastaj një nën shtresë zhavori ose gurë kave të coptuar 10 cm dhe më vonë te shtrohet zgara e celikut Ø4mm, me permasa te kuadrateve 15x15 cm dhe beton M-200 me trashësi 12cm.

Ne te dy anet e rruges ne qender te fshatit Palavli per ne lagje do te shtrohet me bankine zhavori 2x 50cm.

Betoni dote jete I markes **M-200** dhe do te kryhet ngjeshja me vibrator siperfaqesor.


Pas betonimit te rruges do te kihet parasysh trajtimi I shtreses se betonit me uje 2-3 here ne dite kjo sipas temperaturave te larta mbi 37 e 40 grade.

Përsa përket kushteve teknike të zbatimit (KTZ.) për shtresat e zhavorit , shtresave të betonit, markave të betonit dhe zgarave te celikut te jenë sipas standarteve të miratuara.

Sistemimi I këtyre segmenteve rrugore nuk cënon asnjë ndërtim apo pronë private .

Zyra e Planifikimit te Territorit

Ing. Kastriot MUSLLIMI



KRYETARI I BASHKISË

Rigels BALILI

